



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/ 541

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Rashincë

E premte, më 16 qershor 2023

Kohëzgjatja e takimit: 18:00 –19:00

Vendi i takimit: SHMFU “Lasgush Poradeci”

Të pranishëm ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini dhe Drejtori i Shërbimeve Publike - Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, z. Adnan Ademi, i cili i ka përshëndetur të pranishmit dhe i ka falënderuar që kanë gjetur kohë të marrin pjesë në takimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2024-2026. Z. Ademi tregoi që ne sot jemi këtu për të marrë kërkesat e juaja për vitin 2024 për investimet kapitale, duke shtuar që buxheti i Republikës së Kosovës gjithmonë ndahet në bazë të numrit të banorëve, në këtë rast edhe Komuna e Shtimes në bazë të numrit të banorëve e përfiton edhe buxhetin ose grantet qeveritare nga Thesari i shtetit. Ai më tutje dha sqarime sa i përket ndarjes së buxhetit të Komunës së Shtimes dhe tha se si qeverisje duhet t'i marrim prioritet dhe kërkesat e juaja, kryesisht kërkesat e banorëve të fshatit Rashincë dhe t'i vendosim në buxhetin për vitin 2024.

Pas përfundimit të fjalimit të tij, z. Ademi ia kaloi fjalën për sqarime shtesë Drejtorit për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Grejtalb Emini.

Drejtori Emini përshëndeti të pranishmit dhe filloi me sqarimet sa i përket investimeve të cilat janë bërë dhe janë duke vazhduar në të njëjtën kohë. Ai përmendi me radhë rrugët të cilat do të asfaltohen, ndriqohen dhe rrugëve të cilave do t'iu vendoset trotuari e të cilat brenda këtij viti do të përfundojnë. Më tutje ai tha se sa i përket vitit 2024 dhe investimeve të cilat do të bëhen, së bashku me banorët e fshatit Rashincë do të vendosen prioritetet dhe kërkesat e tyre do të jenë në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Kërkesat e banorëve të fshatit Rashincë:

- **Xhemajl Qorrolli:** Shtrati i lumit të rregullohet, ura të cilën e kanë ndërtuar në të kaluarën të demolohet dhe të sigurohet ndriqimi në të gjithë fshatin Rashincë.
- **Refki Qorrolli:** Renovimi i rrugës “Qorrolli” dhe tek rruga “Cani” të rregullohet uji i cili qëndron përmbi rrugë.
- **Sylejman Qorrolli:** Të bëhet një deponi për mbeturina dhe të këtë më shumë inspektorë në terren. Rruga nga Kosharja në Davidoc të zgjerohet.
- **Milaim Rushiti:** Te lumi tek varret e fshatit, ura të bëhet me gilindera mbrojtës.
- **Adil Qorrolli:** Investime në shkollë, shtylla elektrike e cila gjendet afër shkollës të rregullohet, të ndërrohet inventari në shkollë dhe parkingu i shkollës të zgjerohet.
- **Rinor Haxhiu:** Të bëhet ndriqimi në rrugën “Bora” dhe rrugën “Ibrahim Kodra”.
- **Sali Qorrolli:** Në pjesën ku përfundon rruga “Qorrolli” dhe ku lidhet më tranzitin të asfaltohet.
- **Enver Rexha:** Të rregullohet Kanalizimi dhe asfaltimi në rrugën “Rexha”.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve ne mbledhjen e Bordit te Drejtoresve
Date: 16.06.2023

Degjime publike
ne Pashince

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	REFIK QORROLI	Rekoll
2	Edil Qorrolli	Edil
3	Sylejman Qorrolli	Sylejman
4	NAZIF RUSHITI	Nazif
5	Adil Qorrolli	Adil
6	BEKIM CAMLU	Bekim
7	RINOR HAXHIU	Rinor
8	Shemajl Qorrolli	Shemajl
9	MUSTAFA QORROLLI	Musta
10	HINZI ELUSHITI	Hinzi
11	MUHAMET REXHA	Muhamet
12	Arben Qorrolli	Arben
13	Abduselam Rushiti	Abduselam
14	MILAIM RUSHITI	Milaim
15	Reis Rushiti	Reis
16	SALIH QORROLLI	Salih